



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:253636
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05644378

KPPP.nr.1834/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Lenita” Sh.p.k me NUI 810144577, me seli në rrugën “Komandat Kumalla” Shtime, kundër debitorit “TLW” L.L.C me NUI 810823890, me seli në rrugën Ndërrmarja e Re Fabrika e Amortizatorëve KI. Nr. 23 Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokat Fisnik Sogojeva me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.293/21 të datës 17.09.2021, të Përmbartuesit Privat Mubarak S. Shumolli nga Ferizaj, jashtë seancës, me datë 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “TLW” L.L.C, dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.293/21 të datës 17.09.2021 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mubarak S. Shumolli SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.293/21 të datës 17.09.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës Fature nr. 221/20, nr. 220/20 ,nr. 222/20, nr. 223/20, nr. 232/20, nr. 237/20,nr. 263/20, nr. 262/20, nr. 281/20, nr. 282/20, nr. 285/20, nr. 286/20, nr. 284/20, nr. 283/20, nr. 296/20, nr. 298/20, nr. 297/20, nr. 299/20, nr. 304/20, nr. 302/20, nr. 307/20, nr. 306/20, nr. 305/20, nr. 303/20, nr. 321/20 , nr. 319/20 nr. 317/20 nr. 320/20 nr. 322/20 nr. 316/20 nr. 318/20 nr. 331/20 nr. 328/20 nr. 329/20 nr. 327/20 nr. 330/20 nr. 336/20 nr. 333/20 nr. 335/20 nr. 334/20 nr. 332/20 nr. 344/20 nr. 346/20 nr. 345/20 nr. 342/20 nr. 343/20 nr. 351/20 nr. 350/20 nr. 352/20 nr. 371/20 nr. 370/20 nr. 368/20 nr. 367/20 nr. 369/20 nr. 373/20 nr. 374/20 nr. 375/20 nr. 376/20 nr. 377/20 nr. 378/20 nr. 389/20 nr. 390/20 nr. 391/20 nr. 392/20 nr. 396/20 nr. 397/20 nr.

398/20 nr. 395/20 nr. 394/20 nr. 393/20 nr. 404/20 nr. 402/20 nr. 403/20 nr. 407/20 nr. 405/20
406/20 nr. 410/20 nr. 408/20 nr. 409/20 nr. 414/20 nr. 416/20 nr. 415/20 nr. 422/20 nr. 423/20
nr. 421/20 nr. 425/20 nr. 424/20 nr. 438/20 nr. 442/20 nr. 443/20 nr. 444/20 nr. 441/20 nr.
446/20 nr. 445/20 nr. 447/20 nr. 451/20 nr. 452/20 nr. 453/20 nr. 456/20 nr. 455/20 nr. 467/20
nr. 469/20 nr. 470/20 nr. 468/20 nr. 478/20 nr. 476/20 nr. 477/20 nr. 475/20 nr. 665A/20 nr.
683/20 nr. 682/20 nr. 681/20 nr. 680/20 nr. 684A/20 nr. 684B/20 nr. 687/20 nr. 688/20 nr.
689/20 nr. 690/20 nr. 691/20 nr. 692/20 nr. 693/20 nr. 694/20 nr. 695/20 nr. 702/20 nr. 699/20
nr. 700/20 nr. 701/20 nr. 703/20 nr. 714/20 nr. 713/20 nr. 715/20 nr. 723/20 nr. 729/20 nr.
726/20 nr. 725/20 nr. 724/20 nr. 728/20 nr. 727/20 nr. 739A/20 nr. 734/20 nr. 735/20 nr. 736/20
nr. 737/20 nr. 744/20 nr. 747/20 nr. 745/20 nr. 746/20 nr. 755/20 nr. 758/20 nr. 759/20 nr. 756/20
nr. 757/20 nr. 767A/20 nr. 783/20 nr. 786/20 nr. 784/20 nr. 785/20 nr. 782/20 nr. 792/20 nr.
796/20 nr. 797/20 nr. 798/20 nr. 799/20 nr. 800/20 nr. 828E/20 nr. 870/20 nr. 873/20 nr. 871/20
nr. 872/20 nr. 888/20 nr. 889/20 nr. 890/20 nr. 900/20 nr. 901/20 nr. 905/20 nr. 906/20 nr.
924A/20 nr. 924B/20 nr. 924C/20 nr. 930/20 duke urdhëruar debitorin t'ia paguaj kreditorit
shumën e përgjithshme prej 8,580.00 €, me kamatë ligjore prej ditës së parashtrimit të propozimit e
deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbareme aq sa të krijohen
sipas pasqyrës financiare të Organit Përmbareme duke përfshirë edhe shpenzimet e avokatit sipas
Rregullores për Tarifën e Avokatëve.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim përmes të cilit ka kundërshtuar në tërësi
propozimin për përmbareme duke theksuar se debitori nuk i ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat,
të njëjtat nuk i ka nënshkruar dhe në as një formë nuk janë pranuar këto fatura, në CMR nuk figuron
të jetë pranuar nga ana e debitorit, nuk ka as një nënshkrim apo vulë e debitorit, në vazhdim ka
theksuar se kreditori ka kërkuar borxh në emër të 130 faturave duke mos i definuar se për çfarë
borxhi dhe për cilën faturë kërkohet përmbushja, pos tjerash i ka propozuar gjykatës që të aprovet
në tërësi si i bazuar prapësimi ndërsa urdhri përmbareme të anulohet si dhe ka kërkuar shpenzimet
për përpilimin e prapësimit në vlerë prej 104.00 euro.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke e
kundërshtuar prapësimin si të pa bazuar, propozimit për përmbareme i janë bashkangjitur të gjitha
faturat të cilat janë drejtuar debitorit dhe ndaj të njëjtave nuk është bërë asnjë kundërshtim me rastin
e pranimit të faturave, prandaj pretendimet në prapësim janë të pa bazuara dhe prapësimi është

ushtruar vetëm sa për të shtyrë afatin për pagës, pos tjerash i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi si i pa bazuar ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti – Faturat në bazë të cilave është lejuar urdhri përmbarimor nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, ngase nuk mundë të vërtetohet që të njëjtat janë dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se janë pranuar nga debitori, për arsye se faturave iu mungon nënshkrimi apo vula e pranimit nga ana e debitorit.

Në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmoj se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbarimor. Rrjedhimisht, faturat e lëshuara nga kreditori, mirëpo të papranuara nga debitori përbëjnë dokumente të njëanshme dhe si të tilla, nuk janë të përshtatshme për përmbarim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e kreditorit të paraqitur në propozim dhe në përgjigje në prapësim ka theksuar se përveç faturave janë paraqitur edhe CMR-të, në cilësinë e akteve që e shoqërojnë mallin në transportin rrugor ndërkombëtar nga të cilat vërtetohet se malli është pranuar nga ana e debitorit, mirëpo jo dëshmi përmes së cilës mund të arrihet në përfundim se këtu debitori ka pranuar faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri apo se është pajtuar si për nga përmbajtja ashtu edhe lartësia e detyrimit monetar që buron nga këto fatura, për faktin se të njëjtat nuk përmbajnë nënshkrimin apo vulën e debitorit.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e kreditorit të paraqitura në propozim dhe përgjigje në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1834/22, datë 30.04.2024

Gjyqtari

Gent Bkeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.